



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



UDHËZUESI PËR PRAKTIKËN E PUNËS SË OFICERËVE TË SIGURISË (Rishikuar)



Qershor
2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5260 Prot.

Tiranë, më 26.08. 2025

URDHËR

Nr. 413, datë 26.08. 2025

PËR

MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR PRAKTIKËN E PUNËS SË OFICERËVE TË SIGURISË (RISHIKUAR)”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “d” të pikës 5 të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë (rishikuar)”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë” miratuar me shkresën me nr.6155/3 prot, datë 11.10.2023, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Dokumenti “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë” u hartuan nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Hartimi i dokumentit nga:

Esion Zgjana

Kontribuan për përgatitjen e dokumentit:

Esion Zgjana

Aleksandër Gjeçi

Adriana Duka

Arlinda Luka

Elena Sholla

Endi Kazazi

Enkeleda Rapçe

Jerina Dane

Slimentina Musabelliu

Uriana Naçi

Xhesika Gremi

Redaktimi letrar:

Geralda Gjishti

Redaktimi shkencor:

Gerti Janaqi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	2
TERMAT KYÇE	4
PJESA E PARË	5
PARATHËNIE	6
HYRJE	8
ROLI, DETYRAT DHE BASHKËPUNËTORËT E OFICERIT TË SIGURISË NË SHKOLLA	12
SIGURIA NË ISNTUCIONIN ARSIMOR	15
Kontrolli fizik në institucionet arsimore	15
Kontrolli i kamerave dhe sistemeve të sigurisë	15
KOMUNKIMI FORMAL DHE JOFORMAL	17
Komunikimi formal	17
Komunikimi joformal.....	17
PLANIFIKIMI VJETOR	18
SHTOJCA - PLANI VJETOR.....	19
PLANI I SIGURISË SË SHKOLLËS	21
SHTOJCA - PLANI I SIGURISË SË SHKOLLËS	23
FORMAT E RAPORTIMIT	26
MEMO	26
SHTOJCA - MEMO	27
RAPORTI I INCIDENTEVE/PROBLEMATIKAVE.....	28
SHTOJCA - RAPORT I INCIDENTEVE/PROBLEMATIKVE.....	29
SINJALIZIMIT I HERSHËM I SJELLJEVE PROBLEMATIKE	35
FORMULARI I SINJALIZIMIT TË HERSHËM TË SJELLJEVE PROBLEMATIKE. 38	
FORMULARI I NJOFTIMIT TË PRINDIT NË SMIP	40
RAPORTI JAVOR	41
INSTRUMENTI PËR RAPORTIMIN JAVOR	42
RAPORTI VJETOR.....	47
SHTOJCA - RAPORT VJETOR.....	48
PLANI I MASAVE	50
SHTOJCA - PLAN MASASH	51
PROCESVERBALI PËR DOKUMENTIMIN E PRAKTIKËS SË PUNËS	52
PROCESVERBAL	53
REFERIMI I RASTEVE.....	55

SHTOJCA - FORMULARI PËR REFERIMIN E RASTEVE	56
REALIZIMI I VEPRIMTARIVE/AKTIVITETEVE	58
Përshkrimi i rubrikave të formatit.....	58
SHTOJCA-FORMAT I REALIZIMIT TË VEPRIMTARISË	60
INSTRUMENTET MATËSE	61
SHTOJCA - PYETËSOR PËR NXËNËS 1	63
SHTOJCA - PYETËSOR PËR NXËNËS 2.....	69
SHTOJCA-PYETËSOR PËR MËSUES.....	72
SHTOJCA-PYETËSOR PËR PRINDËR	76
PJESA E DYTË.....	79
VLERËSIM PËR PERIUdhËN E PROVËS SË OFICERIT TË SIGURISË.....	80
Metodologjia që do të përdoret.....	80
Instrumentet.....	80
Vlerësimi i oficerëve të sigurisë	82
(Formular vlerësimi që plotësohet nga titullari i institucionit arsimor)	83
(Formular vlerësimi që plotësohet nga oficeri i policimit në komunitet)	86
VLERËSIM PËRMBLEDHËS PËR PERIUdhËN E PROVËS SË OFICERIT TË SIGURISË.....	88
VLERËSIMI VJETOR I OFICERIT TË SIGURISË NGA TITULLARI I INSTITUCIONIT ARSIMOR.....	89
Kriteret e Vlerësimit	89
Dokumentimi	89
Feedback dhe Përmirësim	90
Rezultatet e Vlerësimit.....	90
Rëndësia e Vlerësimit	90
FORMULARI I VLERËSIMIT VJETOR I OFICERIT TË SIGURISË NGA TITULLARI I INSTITUCIONIT ARSIMOR	91

TERMAT KYÇE

OS: Oficeri i sigurisë

ZVAP: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

ASCAP: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MAS: Ministria e Arsimit dhe Sportit

MASR: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

SPZ: Specialisti i Policisë së Zonës

IA: Institucion Arsimor



PJESA E PARË

PARATHËNIE

Lufta kundër dukurive të tilla si, episode të dhunës apo përdorimi i drogave në shkolla janë prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Brendshme. Ministria e Brendshme ka ndërmarrë shumë nisma në lidhje me sigurinë, ku ka një vëmendje të veçantë në rritjen e sigurisë si brenda ashtu edhe jashtë perimetrit të institucioneve arsimore nëpërmjet patrullimit të shpeshtë të policisë si dhe një sërë masash të tjera. Prania e policisë është një ndër elementet e shumta të sigurisë në shkolla. Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkonte një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe stafin e shkollës, gjë të cilën policia nuk mund ta arrinte duke pasur parasysh natyrën sensitive të mjedisit shkollor.

Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me anë të marrëveshjes së firmosur midis palëve, krijuan një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurt - Oficerët e Sigurisë në shkolla”.

Kjo qasje synonte të realizohej nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë së shkollës.

Projekti kishte si qëllim kryesor garantimin e një mjedisi të sigurt mes nxënësve brenda në shkollë si dhe një mjedis të sigurt për ta në territorin e shkollës. Projekti filloi si një projekt pilot në 15 shkolla të mesme në qytetin e Tiranës. Për realizimin e këtij projekti të dyja ministrinë përgjegjëse ngritën grupet e punës respektive të cilat filluan punën e përbashkët.

Projekti u pilotua në 15 gjimnaze të qytetit të Tiranës, për t’u shtrirë më vonë në të gjithë vendin. Për fazën e pilotimit të projektit në këto shkolla u dislokuan oficerë të forcave të rendit në detyrë, të cilët kishin marrë të gjitha trajnimet e nevojshme nga Akademia e Sigurisë, sipas një kurrikule të përgatitur posaçërisht për ta.

Oficerët e sigurisë janë dislokuar në shkolla më datë 15.03.2018 dhe qëndruan deri në përfundim të vitit akademik parauniversitar. Raportimi i tyre të strukturat përkatëse është bërë sipas disa formave të raportimit të vendosura në dispozicion nga grupi i punës i MAS (MASR në atë kohë), ku raportohet për incidentet apo situatat, raportimin javor, vjetor dhe memo. Oficerët e sigurisë kanë raportuar në mënyrë periodike pranë strukturës përgjegjëse në

Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës. Gjatë periudhës së pilotimit OS janë lehtësuar dhe vëzhguar gjatë procesit të punës së tyre edhe nga grupi i punës i MASR.

Rezultatet e përfuara nga pilotimi mbi rritjen e çështjeve të sigurisë në shkollë i hapën rrugën fillimit të procedurave të rekrutimit të oficerëve të sigurisë në shkollë, ku grupi i parë i oficerëve të sigurisë të vendosur në shkollë i përket muajit mars të vitit 2019.

Me anën e VKM-së nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar, përcaktohet dhe rregullohet pozicioni i oficerit të sigurisë në shkollë, numri i tyre dhe shpërndarja e tyre në institucionet e arsimit parauniversitar.

HYRJE

Siguria në shkolla është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës. Lufta kundër dukurive të tilla si; episode të dhunës apo përdorimi i drogave në shkolla, janë prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme. Të tjera dukuri të cilat krijojnë potencial për cenimin e sigurisë nëpër shkolla janë: burimet e aksidenteve brenda shkollës, cenimi i territorit të shkollës nga persona të paautorizuar apo ngacmimet në perimetrin e jashtëm të shkollës.

Procesi i planifikimit të hartimit të dokumentit të sipërcituar filloi zyrtarisht në vitin 2023. Procesi i hartimit kaloi në disa faza kryesore, ku faza e parë ishte hulumtimi i praktikave ndërkombëtare për funksionimin e sigurisë në institucionet arsimore.

Kontekstualizimi i praktikave ndërkombëtare ka qenë një proces i cili ka marrë vëmendje të rëndësishme, gjithashtu hartimi i dokumentit është bazuar në aktet ligjore në fuqi për arsimin parauniversitar, për funksionimin e pozicionit të oficerëve të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave personale, për burimet njerëzore në dispozicion dhe për strukturën e institucioneve arsimore.

Deri tani oficerët e sigurisë e kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre profesionale bazuar në instrumente jo zyrtare dhe dokumentimi i punës së tyre është një element mjaft i rëndësishëm për sa i përket aspekteve të sigurisë në institucionet arsimore. “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë” është një përmbledhje e praktikës dhe rutinës të përgjithshme të punës së oficerëve të sigurisë. Ky dokument është një kornizë konceptuale e hapësirës profesionale të kësaj strukture brenda institucionit arsimor.

Dokumenti është mbështetur në praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, që prej fillimit të funksionimit të këtij shërbimi, në praktikat ndërkombëtare, në nevojat e identifikuara të punonjësve dhe në raport me rolin e tyre në institucionet arsimore (IA).

Ky dokument iu vjen në ndihmë oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore publike, titullarëve të institucioneve arsimore dhe strukturave të tjera që janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin e praktikës së punës së këtij shërbimi.

Përgjatë gjithë ndryshimeve në sistemin arsimor parauniversitar, vitet e fundit, problematikat më të cilat u përballë shoqëria jonë, prej vitit 2019 (tërmeti, pandemia etj.), dhe problematikave të reja që mund të identifikohen në të ardhmen, ky udhëzues synon të orientojë oficerët e sigurisë, në ofrimin e shërbimeve efektive dhe profesionale, në përputhje me nevojat aktuale të shërbimit dhe të përfituesve të tij.

Procesi i hartimit të dokumentit u koordinua nga specialistët e fushës në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, dhe u përfshinë në këtë proces oficerë të sigurisë, të cilët hartuan draftet, rishikuan të gjitha komentet dhe sugjerimet që rezultuan nga intervistat, pyetësorët dhe fokus grupe.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është hartimi i disa dokumenteve të punës së oficerit të sigurisë në shkolla për të garantuar një mjedis të sigurt mes nxënësve brenda në shkollë si dhe një mjedis të sigurt për ta në territorin e shkollës.

- Përmirësimin e sigurisë faktike dhe të perceptuar në shkolla dhe përreth tyre.
- Krijimin e Rrethit të Sigurisë nëpërmjet parandalimit të dukurive negative që në gjenezë në bashkëpunim me stafin pedagogjik, shërbimin psiko-social të shkollës dhe prindërit.
- Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policimit në komunitet.
- Përmirësimi i perceptimit të oficerit të sigurisë në mesin e të rinjve.
- Të përmirësojë marrëdhëniet midis nxënësve dhe policisë.

Disa parime që duhen mbajtur mend përgjatë hartimit të këtij udhëzuesi janë:

- *Integriteti, profesionalizmi dhe diskrecioni* – Për vetë natyrën delikate të kësaj detyre, integriteti i lartë dhe profesionalizmi janë vlera të *panegociueshme*. Vetëm kandidatët që disponojnë këto vlera mund të garantojnë suksesin në kryerjen e kësaj detyre. Përzgjedhjet e gabuara për këtë detyrë krijojnë një potencial të madh risku dhe situatash të vështira.
- *Shembulli pozitiv* – Oficeri i sigurisë nga vetë specifika ka potencial të jetë një nga rolet më me ndikim tek të rinjtë, ndaj dhe shembulli pozitiv është një detyrë kyçe. Oficeri i sigurisë e përcakton këtë rol pozitiv duke treguar shembullin personal, duke përcaktuar kufijtë dhe duke qenë i qartë rreth asaj që është e pranueshme dhe e papranueshme, duke qenë i sinqertë, me integritet dhe duke qenë inkurajues për nxënësit, bashkëpunues me stafin pedagogjik dhe mbështetës me prindërit.

- *Serioziteti i detyrës:* Duhet të marrë seriozisht shqetësimet dhe të ndjekë hapat e duhur për të ndërmarrë një veprim siç përcaktohet në procedurat standarde dhe në konsultim të vazhdueshëm me drejtorinë e shkollës. Në rast se oficeri i sigurisë nuk gjen zgjidhje në drejtorinë e shkollës, i drejtohet me shkrim ose nëpërmjet telefonit Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit pranë ZVA-së përkatëse.
- *Krijimi i marrëdhënieve të mira* – Një aspekt kritik për suksesin e oficerit të burimeve shkollë është krijimi i marrëdhënieve me stafin e shkollës, shërbimin psiko-social të shkollës, oficerin e policimit në komunitet, prindërit, dhe veçanërisht nxënësit. Është e rëndësishme që oficeri të jetë i vetëdijshëm për shërbimet që ofrohen nga specialistë të shkollave si: këshilltarë udhëzues, infermierë shkollorë, psikologë të shkollave, punëtorë social të shkollës dhe duhet të krijojë një klimë bashkëpunuese.
- *Paraqitje korrekte e oficerit të sigurisë në shkollë.*

Rolet dhe përgjegjësitë e oficerit të sigurisë (OS) duhet të jenë të mirëpërcaktuara dhe duhet t'i përshtaten kontekstit të zonës dhe komunitetit ku operojnë.

Ruajtja e rendit të brendshëm me synim parandalimin e dhunës dhe kriminalitetin në shkollë, si dhe frenimin e dukurive të ndryshme, si, tentativa të shitjes së lëndëve narkotike apo ngacmime që ndodhin në perimetrin e jashtëm të shkollës.

Monitoron mjediset brenda dhe përreth shkollës për garantimin e sigurisë dhe minimizimin e risqeve (si për shembull rreziqet nga zjarret, lëndët plasëse apo burime aksidentesh).

Evidenton dhe raporton pranë oficerit të policimit në komunitet situata të parregullta të rendit dhe sigurisë publike brenda dhe në perimetrin e jashtëm të shkollës.

Evidenton, raporton dhe në bashkëpunim me shërbimin psiko-social të shkollës ndërmjetëson situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës.

Ruan komunikim të përditshëm dhe bashkëpunon me oficerin e policimit në komunitet në zonën përkatëse.

Përfshihet në politikat e disiplinës, vlerësimet e sigurisë në shkollë, sigurinë fizike të shkollës, menaxhimin e krizave, emergjencave, planifikimin, parandalimin ose ndërhyrjen e krimit dhe proceset e tjera të planifikimit të sigurtë të shkollave.

Merr pjesë në takimet me prindër apo takime periodike të të gjitha palëve të përfshira duke raportuar mbi situatën e sigurisë në shkollën respektive ,duke evidentuar problematika dhe diskutuar zgjidhje.

Arsimi i lidhur me ligjin në mënyrë periodike mban leksion tek nxënësit për t'u dhënë bazat e aftësive të nevojshme, për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm. Edukimi në lidhje me ligjin iu mëson kompetencën sociale, aftësinë e zgjidhjes së problemeve dhe përforcon prirjet e të rinjve për norma pozitive.

1. OS nuk do të ndërmarrë masa disiplinore në shkollë, megjithatë OS do të raportojë çdo shkelje të disiplinës së shkollës pranë administratës së shkollës.
2. OS nuk do të zhvillojë kontrole fizike apo të mjediseve përveç rasteve të emergjencave dhe vendimit nga administrata e shkollës.

ROLI, DETYRAT DHE BASHKËPUNËTORËT E OFICERIT TË SIGURISË NË SHKOLLA

Qëllimi i oficerit të sigurisë në shkolla është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës. Përfshirja e oficerit të sigurisë në shkollë synon rritjen e sigurisë përmes mbështetjes dhe ndërveprimit.

Siguria në shkollë është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës. Lufta kundër dukurive të tilla, si episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkolla etj., janë objektivi kryesor në funksion të rolit dhe zbatimit të detyrave të oficerëve të sigurisë.

Oficeri i sigurisë në shkolla ka në fokus të punës **identifikimin** sa më herët të situatës në të cilën gjendet nxënësi me problematika të tilla, si sjellore, ndërvepruese, braktisje shkollore, përdorimit apo shpërndarjes së lëndëve narkotike, kanosjeve, e të tjera.

Oficerët e sigurisë në shkollë janë burime të vlefshme të shkollave për **krijimin e një mjedisi të sigurt**, përmes ndërtimit të marrëdhënieve të forta e të qëndrueshme me nxënësit, stafin e shkollës, prindërit dhe komunitetin.

Oficerët e sigurisë në shkolla **ndihmojnë** punonjësit arsimorë, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve dhe anasjelltas, të nxënësve ndaj bashkëmoshatarëve dhe përfshirjes së tyre në sjellje abuzive të tilla ,si konsumimi i duhanit, i alkoolit, i drogës etj.

Oficerët e sigurisë në shkolla **informojnë** punonjësit e institucionit arsimor për raste të caktuara të përfshirjes së nxënësve në sjellje të rrezikshme dhe për problemet që hasin nxënësit gjatë kalimit të kohës në pushimin e madh, apo gjatë ardhjes në shkollë apo ikjes. Raportojnë me shkrim për çdo rast të provuar apo të dyshuar, për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimorë dhe nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, te drejtuesi i IA, Koordinatori në ZVAP dhe në raste specifike Policisë së Shtetit.

Oficerët e sigurisë në shkolla **ndërhyjnë** për të ndihmuar nxënësit për zgjidhjen e konflikteve, për parandalimin e abuzimit, parandalimin e bullizmit, etj., nëpërmjet këshillimit/konsultimit individual dhe në grup me nxënës, gjithashtu konsultojnë dhe informojnë personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Oficerët e sigurisë në shkolla zhvillojnë veprimtari **ndërgjegjësuere/informuese**, në kuadër të ditëve ndërkombëtare të specifikuara në udhëzimin përkatës të fillimit të vitit shkollor, si dhe të rregullores së brendshme të shkollës, temave me natyrë të mbrojtjes dhe sigurisë së tyre, përdorimit të sigurt të internetit, raportimit të rasteve të shantazhit, kërcënimit apo kanosjes.

Oficerët e sigurisë në shkolla janë punonjës joarsimor që duhet të ngjallin **besim** tek nxënësit dhe jo të krijojnë një situatë terrori apo presioni në mjedisin e shkollës.

Ata janë të përgatitur dhe të trajnuar për të përmbushur rolet e tyre, siç janë:

Si oficerë të zbatimit të ligjit:

- parandalojnë dhe menaxhojnë rastet e krimit dhe të dhunës në shkollë, duke kontribuar në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, autoritetin dhe drejtësinë;
- punojnë ngushtë me drejtorinë e shkollës dhe me stafin e saj për parandalimin dhe ndërhyrjen në rastet e thyerjes së disiplinës, për menaxhimin e krizave dhe në rastet e emergjencave etj.;
- shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet policisë, të rinjve dhe shkollës.

Si këshillues për ligjin dhe sigurinë:

- shërbejnë si partnerë dhe këshillues të administratës së shkollës;
- evidentojnë, raportojnë dhe në bashkëpunim me shërbimin ndërmjetësojnë situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës;
- u ofrojnë prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.

Si ndërgjegjësues:

- marrin pjesë në takimet me prindër dhe në takime periodike të stafit pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë;
- në mënyrë periodike, zhvillojnë leksione ose biseda me nxënësit, me qëllim ndërgjegjësimin rreth dukurive dhe kërcënimeve të mundshme, si dhuna, substancat narkotike, trafikimi, siguria fizike nga zjarri etj.;
- shërbejnë si modele rolesh pozitive për nxënësit dhe edukojnë vlerat e sistemit tonë ligjor.

Oficeri i sigurisë në shkollë zbaton veprimtaritë e parashikuara në planin vjetor ose veprimtari të bazuara në nevojat specifike të shkollës, të identifikuar gjatë vitit shkollor. Veprimtaritë mund të jenë në formën e parandalimit, të vlerësimit dhe të ndërhyrjes.

SIGURIA NË ISNTUCIONIN ARSIMOR

Kontrolli fizik në institucionet arsimore

Oficeri i sigurisë zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve në raste emergjente ose me vendim nga drejtoria e IA-së.

Kontrolli i sendeve personale të nxënësve zakonisht bëhet për të siguruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm në shkolla. Ky kontroll mund të përfshijë:

1. **Raste emergjente:** në raste konfliktesh kur situatat mund të agravojnë,
2. **Në rast dyshimi:** Nëse ka dyshime për sende të paligjshme apo të rrezikshme.

Procedurat e kontrollit duhet të jetë e njëjtë në të gjitha shkollat, por theksi vihet gjithmonë në sigurinë e nxënësve dhe mirqenien e tyre.

Kontrolli fizik do të bëhet me praninë e mësuesit kujdestar dhe drejtuesit të institucionit arsimor. Në raste emergjente duhet të merren masa që oficeri i sigurisë të vlerësoj shëndëtin, sigurinë dhe mirëqenien e palëve të përfshira.

Pasi të ndodhi kontrolli fizik i nxënësit/ve, oficeri i sigurisë dokumenton punën e tij me raport incidentit apo problematike nëse ka konstatuar mjete të paligjshme dhe një procesverbal sipas formatit tip.

Në rast se nuk konstatohet mjete të paligjshme, oficeri i sigurisë harton vetëm procesvabalin sipas formatit tip që sqarson arsyet dhe rrethanat e kontrollit fizik.

Kontrolli i kamerave dhe sistemeve të sigurisë

Kamerat në shkolla përdoren për disa qëllime, përfshirë:

1. **Siguria:** Ato ndihmojnë në mbajtjen e një ambienti të sigurt për nxënësit dhe stafin duke monitoruar aktivitetet dhe ndihmuar në identifikimin e incidenteve të mundshme.
2. **Parandalimi i krimeve:** Prania e kamerave mund të ndihmojë në parandalimin e vjedhjeve, dhunës, ose ngjarjeve të tjera të papërshtatshme.
3. **Monitorimi i sjelljes:** Disa shkolla i përdorin kamerat për të mbikëqyrur sjelljen e nxënësve në ambiente të ndryshme, si në korridore, oborre, dhe ambiente të tjera publike.

4. **Mbështetje në hetime:** Në rastin e ndonjë incidenti, videot e regjistruara mund të shërbejnë si prova për hetime të mëtejshme.
5. **Pranimi i vizitorëve:** Disa shkolla përdorin kamerat për të monitoruar hyrjet dhe daljet, duke siguruar që vizitorët të jenë të identifikuar.

Është e rëndësishme që përdorimi i kamerave të respektojë privatësinë e nxënësve dhe stafit dhe të ndjekë ligjet dhe rregulloret përkatëse.

Sistemi i kamerave dhe i sigurisë së shkollës administrohet nga titullari i institucionit arsimor apo persona të tjerë të ngarkuar, por kur është e nevojshme sistemi i kamerave dhe i sigurisë në shkollë mund të aksesohet nga oficeri i sigurisë mbështetur në legjislacionin në fuqi.

KOMUNKIMI FORMAL DHE JOFORMAL

Komunikimi formal

Komunikimi i oficerit të sigurisë në institucionet arsimore me drejtuesit, me mësuesit, me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me nxënësit mund të jetë formal dhe joformal.

Gjatë komunikimit formal kërkohet dokumentimi i tij, në një nga format zyrtare, sipas formateve përkatëse (relacione, raportime javore etj.). Komunikimi kërkohet të realizohet në mjedisin ku ofrohet shërbimi ose brenda mjediseve të institucionit arsimor.

Dokumentohen dhe duhet të jenë në dosjen e oficerit të sigurisë:

1. Planifikimi vjetor i veprimtarive dhe aktivitete të oficerit të sigurisë.
2. Plani i sigurisë së shkollës
3. Format i shkresës “Memo”.
4. Raporti i incidenteve dhe problematikave.
5. Raportimi vjetor i incidenteve dhe problematikave
6. Sinjalizimi hershëm i sjelljeve problematike
7. Raporti javor.
8. Raporti vjetor.
9. Plani i masave.
10. Procesverbali për dokumentimin e praktikës së punës.
11. Rastet që oficeri i sigurisë referon për situata që tejkalojnë kompetencat e pozicionit të tij.
12. Realizimi i veprimtarive praktike, veprimtarive apo takimeve informuese
13. Instrumentet matëse për mësues dhe nxënës

Komunikimi joformal

Nuk nevojitet dokumentimi i komunikimeve për rastet, kur oficeri i sigurisë në shkollë, njofton për organizimin e veprimtarive informuese/ndërgjegjësuere me mësues dhe/ose persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Njoftimi i këtyre veprimtarive realizohet përkatësisht në bashkëpunim me drejtuesit dhe/ose mësuesit.

PLANIFIKIMI VJETOR

Oficeri i sigurisë në institucionet arsimore planifikon veprimtari brenda institucionit në përshtatje me strukturën e vitit shkollor. Planifikimi vjetor i veprimtarisë së oficerit të sigurisë në institucionet arsimore realizohet në përputhje me nevojat e institucionit, me gjetjet e analizës vjetore të vitit shkollor të mëparshëm, të strategjive kombëtare, të udhëzimit të çdo fillimi të vitit shkollor. Oficerët e sigurisë në shkollë planifikojnë veprimtaritë që do të ofrojnë për nxënësit, për stafin e shkollës dhe për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, pasi kanë vlerësuar nevojat e tyre.

Plani vjetor është forma e cila do të përshkruaj objektivat e punës së oficerit të sigurisë dhe treguesit të përmbushjes së secilit objektiv. **Ky plan hartohet në fillim të vitit shkollor dhe dërgohet për miratim tek titullari i institucionit arsimor, një kopje i dërgohet personit të ngarkuar si anëtar i Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit në çdo ZVAP apo personit të ngarkuar nga ZVAP-ja për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

SHTOJCA - PLANI VJETOR
PËR VITIN SHKOLLOR

20__-20__

Nr .	Objektivi i përgjithshëm	Nr.	Objektiva t	Nr.	Treguesi t	Përshkrim i i treguesit	Afati i realizimi	Personi përgjegjës
1		1.1		1.1.1				
				1.1.2				
				1.1.3				
		1.2		1.2.1				
				1.2.2				
2		2.1		2.1.1				
				2.1.2				
				2.1.3				
		2.2		2.2.1				
				2.2.2				
3		3.1		3.1.1				
				3.1.2				
				3.1.3				
		3.2		3.2.1				
				3.2.2				
4		4.1		4.1.1				
				4.1.2				
				4.1.3				
		4.2		4.2.1				
				4.2.2				

HARTOI

Oficeri i sigurisë

_____/_____/20_____
 (emër mbiemër) (nënshkrimi) (data)

MIRATOI

Titullari i institucionit arsimor

_____/_____/20_____
 (emër mbiemër) (nënshkrimi) (data)

PLANI I SIGURISË SË SHKOLLËS

Në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe të ruajtjes së sigurisë në ambientet e brendshme dhe të rrethimit të shkollës, nga oficeri i sigurisë në shkollë hartohet plani i sigurisë. **Ky plan hartohet në varësi të nevojave të institucionit arsimor në çdo fillim viti të ri shkollor dhe dërgohet për miratim tek titullari i institucionit arsimor.**

Për hartimin e planit të sigurisë së shkollës, oficeri i sigurisë do të mbështetet në strukturën që do të gjejë në shtojcën vijuese, ku secili oficer sigurie këtë strukturë do ta përmbushë sipas karakteristikave të institucionit arsimor ku ai është i punësuar.

Është e rëndësishme që vetë shkolla me aktorët e saj, sikurse dhe institucionet e tjera arsimore përgjegjëse, të kenë një informacion të domosdoshëm në lidhje me karakteristikat e shkollës.

Mund të përmendim disa nga këto karakteristika apo elemente dhe tipare dalluese të shkollës, si informacioni në lidhje me godinën e shkollës, sigurimin e ndërtesës, risqe të evidentuara nga oficeri i sigurisë së shkollës, vendndodhja e zonës ku ndodhet shkolla, daljet e emergjencës së godinës, stafi menaxhues i emergjencave në shkollë, numrat e emergjencës dhe të tjera në varësi të specifikave të ndryshme që secila shkollë mund të ketë. Plan i sigurisë së shkollës do të ketë strukturën si më poshtë vijon:

1. *Baza ligjore.* Në këtë pikë do të përmendet e gjithë baza ligjore e përdorur për hartimin e planit të sigurisë së shkollës.
2. *Godina e shkollës,* këtu informacioni përfshin: vitin e ndërtimit apo rikonstruktimit, gjendjen aktuale të godinës, rehabilitimi i fundit i shkollës, numrin e kateve të godinës dhe të tjera informacione të veçanta të shkollës.
3. *Sigurimi i ndërtesës* përfshin: hyrje-daljen në godinë, perimetrin e saj rrethues, sa i sigurt është apo jo, etj.
4. *Risqe të evidentuara nga oficeri i sigurisë së shkollës:* një godinë e amortizuar, një perimetër me probleme, një akses në godinë pa infrastrukturë të duhur dhe situata të ndryshme.
5. *Vendndodhja e shkollës:* përshkrimi i zonës ku ajo ndodhet, mundësia për akses, rrugët të cilat e mundësojnë atë, sikurse informacione të tjera në varësi të secilës shkollë dhe individualiteteve të saj.

6. *Daljet e emergjencës*: secila shkollë vendos në dispozicion të oficerit të sigurisë, planimetrinë e godinës për secilin kat. Në rastet kur nuk ndodhen, mund të gjenden alternativa të tjera se si mund të sigurohen këto skica ose mund të punohen nga aktorë të shkollës në bashkëpunim me oficerin e shkollës. Nga oficeri i sigurisë realizohen daljet e emergjencës, ku me shigjeta tregohet orientimi i duhur i lëvizjeve në raste emergjente.
7. *Stafi menaxhues i shkollës në raste emergjencash*: përfshin emrat e personave të përzgjedhur, sikurse pozicioni punës dhe kontaktet e tyre.
8. *Numrat e shërbimit në rast e emergjencës*: Në shkollë afishohen numrat e emergjencave.
9. *Siguria (Sistemi i Sigurisë)*, përfshin: emri i firmës që e menaxhon, kontakti i personit/personave përgjegjës, informacion për sistemin e kamerave, numri i tyre, mbulimi i sipërfaqes etj.
10. *Mbrojtja nga zjarri*. Në këtë pikë do të përfshihen procedurat që ndiqen nga pjesëtarë të stafit të shkollës në rast emergjente, veprimet që duhet të kryhen, reagimet ndaj një zjarri në fazën fillestare, procedura për evakuimin e punonjësve dhe nxënësve të pranishëm në rast zjarri në objekt dhe hapat e përdorimit të fiksës së zjarrit.
11. *Tërmeti*. Në këtë pikë do të përfshihen procedurat që ndiqen gjatë kohës së tërmetit, udhëzime për tërmetin, stafin menaxhues, informacionet të tjera, etj.
12. *Përmbytja*. Në këtë pikë do të përfshihen procedurat dhe veprimet reaguese që ndiqen nga pjesëtarë të stafit të shkollës kur raportohen ose vërehen përmbytje dhe pasi ka ndodhur përmbytja.

Sigurimi të dhënave të përmendura më lart do të ndihmojë, mbrojtë shkollën duke e bërë atë më të sigurt. Duke pasur parasysh se nga shkolla duhen të merren të gjitha masat e nevojshme në rastet e fatkeqësive natyrore apo emergjencave si, tërmet, përmbytje, pandemi, zjarr etj., përcaktohen procedurat që ndiqen nga pjesëtarë e stafit të shkollës apo dhe nxënësit. Këto të dhëna do të ndihmojnë në procedurat e evakuimit, në minimizimin dhe parandalimin e problemeve të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

SHTOJCA - PLANI I SIGURISË SË SHKOLLËS
PËR VITIN SHKOLLOR

20__-20__

1. Baza ligjore

Plani i Sigurisë për vitin shkollor 20__-20__, u hartua, në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe të ruajtjes së sigurisë në ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës.

Ky plan për Vitin Shkollor 20__-20__ u hartua në përputhje me: Bazën ligjore:

-
-
-

2. Institucioni arsimor “XXX” (godina e shkollës):

- Institucioni arsimor “XXX” viti ndërtimit/ rikonstruktimit: _____
- Rehabilitimi i fundit i shkollës: _____
- Godina e institucionit arsimor “XXXX” është ____katesh.
- Në katin e ____ dhe ____ të shkollës do të zhvillojnë procesin mësimor ____klasa.

Në godinën e shkollës funksionojnë mjediset si më poshtë:

-
-
-
-
-
-
-

3. Sigurimi i ndërtesës

- Hyrja në godinë (si realizohet).
- Informacion i përgjithshëm sipas specifikës së çdo shkolle.
- Perimetri i saj kur ka dhe nuk ka probleme.

4. Riske të evidentuara nga oficeri i sigurisë së shkollës

Problemet qe oficeri evidenton (nëse ka).

5. Vendndodhja

- Harta e shkollës e institucionit arsimor “XXX”,
- Akses i për në shkollën “” realizohet nga Rr....
- Vendndodhja e shkollës “” (përshkrimi i zonës ku ndodhet, mundësia për akses, informacione të tjera në varësi të secilës shkollës dhe individualiteteve të saj.)

6. Daljet e emergjencës

Planimetria e secilit kat, me shigjeta daljet e emergjencës.

7. Staf i menaxhues i shkollës në raste emergjencash

Adresa e shkollës:	
Tel:	
E-mail:	

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni/roli	Tel	e-mail
1.				
2.				
3.				
.....				

8. Numrat e shërbimit në rast emergjence

Shërbimet e Emergjencave

9. Siguria (sistemi i sigurisë)

- Emri firmës që e menaxhon;
- Kontakt i personit/personave përgjegjës;
- Informacion për sistemin e kamerës, numri i tyre, mbulimi i sipërfaqes etj.

10. Mbrojtja nga zjarri

- Procedura që ndiqet nga pjesëtarë të stafit të shkollës në raste emergjente.
- Veprimet që duhet të kryhen dhe reagimet ndaj një zjarrit në fazën fillestare.
- Procedura për evakuimin e punonjësve dhe nxënësve të pranishëm në rast zjarri në objekt.
- Hapat e përdorimit të fiksës së zjarrit.

11. Tërmeti:

- Si duhet vepruar gjatë kohës së tërmetit;
- Udhëzime për tërmetin;
- Stafi menaxhues;
- Stimulimi;
- Broshura informuese;
- Etj.

12. Përmbytja

Veprimet Reaguese:

- Raportohen ose vërehen përmbytje
- Pas përmbytjes

HARTOI

Oficeri i sigurisë

(emër mbiemër)

(nënshkrimi)

____/____/20____
(data)

MIRATOI

Titullari i institucionit arsimor

(emër mbiemër)

(nënshkrimi)

____/____/20____
(data)

FORMAT E RAPORTIMIT

MEMO

Është parashikuar si formë raportimi i brendshëm ndërmjet oficerit të sigurisë dhe **titullarit të institucionit arsimor, personit të ngarkuar si anëtar i Zyrës së Koordinimit dhe monitorimit në çdo ZVAP apo personit të ngarkuar nga ZVAP-ja për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla.**

Memorandum (shkurt: memo, nga latinishtja, që do të thotë se, “Duhet të mbahet mend ...”) është një shënim, dokument a çdo komunikim tjetër që ndihmon kujtesën duke regjistruar ngjarje, sinjalizim për një situatë të caktuar, tërheqje të vëmendjes ose vërejtje mbi një temë të caktuar brenda strukturave të një institucioni arsimor.

Memo gjithashtu njihet si një nga format e komunikimit të brendshëm dhe institucional në Republikën e Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

SHTOJCA - MEMO

Për: Z/Znj. XXX XXXXXXX

(Pozicioni dhe institucionit)

Për dijeni: Z/Znj. XXX XXXXXXX

(Pozicioni dhe institucionit)

Nga: Z/Znj. XXX XXXXXXX

(Pozicioni dhe institucionit)

Datë: DD.MM.VVVV

Subjekti: Mbi "XXXXXXX"

I nderuar Z. Znj. XXX,

RAPORTI I INCIDENTEVE/PROBLEMATIKAVE

Është parashikuar të përdoret për të gjitha natyrat e incidenteve/problematikeve që mund të përballet oficeri i sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës. Theksojmë se raportimi për këtë formular duhet të bëhet në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”; me ligjin rr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për krijimin e pozicionit të oficerit të sigurisë.

Raporti i incidenteve/problematikave i drejtohet **titullarit të institucionit arsimor, personit që ushtron përgjegjësinë prindërore (përmes SMIP), personit të ngarkuar si anëtar i Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit në çdo ZVAP apo personit të ngarkuar nga ZVAP-ja për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla, organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit), dhe strukturave për mbrojtjen e fëmijës (për rastet kur vlerësohet fëmijës i duhet dhënë mbrojtja).**

SHTOJCA - RAPORT I INCIDENTEVE/PROBLEMATIKVE

DRAP:		ZVAP:	
Shkolla:		Lloji i shkollës:	☐ Publik ☐ Privat
Data e plotësimit të raportit:		____/____/20____	
Data e incidentit/problematikës:		____/____/20____	____/____/20____
Zona e shkollës:	☐ Rurale ☐ Urbane		
Lloji i shkollës:	☐ Arsim fillor ☐ Arsim i Mesëm i Ulët	☐ Arsim Bazë ☐ Arsim i Mesëm i Lartë ¹	

Personi i cili raportoi/konstatoi incidentin/problematikën:

Emër Mbiemër

Vet nxënësi
 Punonjësi i shërbimit psiko-social
 Oficeri i sigurisë
 Punonjësit arsimor (mësuesit)
 Stafi drejtues
 Nxënës (dëshmitar)
 Prindër/familjar
 Roja/sanitarja/sekretarja
 Tjetër (specifiko) _____

¹ Gjinnazet, shkollë e mesme e bashkuar, shkollat me drejtim të orientuar, shkollat profesionale.

Lloji i incidentit/problematikës së ndodhur:

☐	Përdorimi i drogës/cigares/alkoolit	☐	Posedimi/shpërndarja e drogës
☐	Armëmbajtje	☐	Zjarrvënie e qëllimshme/ fishekzjarrë
☐	Bulling (ngacmim/tallje/fyerje)	☐	Krim interneti
☐	Vjedhje/thyerje	☐	Kërcënim/ shantazh/ përndjekje
☐	Ngacmim seksual	☐	Thyerja e rregullores së shkollës
☐	Sulm me armë zjarri/të tjera	☐	Ekstremizëm i dhunshëm
☐	Dhunë psikologjike/ verbale	☐	Tentativë vetëvrasje/ vetëvrasje
☐	Prishje e pronës	☐	Kërcënim me bombë
☐	Dhunë fizike	☐	Diskriminim/racizëm
☐	Vandalizëm	☐	Neglizhim
☐	Dhunë seksuale	☐	Ngjarje aksidentale
☐	Problem shëndetësor	☐	Tjetër (specifiko) _____

Personi që shkaktoi

incidentin/problematikën:

☐	Nxënës
☐	Punonjësi i shërbimit psiko-social
☐	Oficeri i sigurisë
☐	Punonjësit arsimor (mësuesit)
☐	Stafi drejtues
☐	Prindër/familjarë
☐	Roja/sanitarja/sekretarja
☐	Të huaj/komuniteti
☐	Tjetër (specifiko) _____

Personi ndaj të cilit u shkaktua

incidenti/problematika:

☐	Nxënës
☐	Punonjësi i shërbimit psiko-social
☐	Oficeri i sigurisë
☐	Punonjësit arsimor (mësuesit)
☐	Stafi drejtues
☐	Prindër/familjarë
☐	Roja/sanitarja/sekretarja
☐	Të huaj/komuniteti
☐	Tjetër (specifiko) _____

**Personi që shkaktoi
incidentin/ problematikën:**

Gjinia

Emër Mbiemër	F	M

**Personi ndaj të cilit u
shkaktua incidenti/
problematika:**

Gjinia

Emër Mbiemër	F	M

**Personi që shkaktoi
incidentin/problematikën është në
klasën:²**

☐	I
☐	II
☐	III
☐	IV
☐	V
☐	VI
☐	VII
☐	VIII
☐	IX
☐	X
☐	XI
☐	XII

**Personi ndaj të cilit u shkaktua
incidenti/problematika është në klasën:³**

☐	I
☐	II
☐	III
☐	IV
☐	V
☐	VI
☐	VII
☐	VIII
☐	IX
☐	X
☐	XI
☐	XII

² Plotësohet vetëm nëse personi që shkaktoi incidentin/problematikën është nxënës.

³ Plotësohet vetëm nëse personit ndaj të cilit u shkaktua incidenti/problematika është nxënës.

Mjedisi ku ndodhi incidenti/problematika:

☐	Ambientet sportive	☐	Korridor
☐	Në klasë me mësuesin/punonjës	☐	Në klasë pa mësuesin/punonjës
☐	arsimor	☐	Duke ardhur në shkollë
☐	Tualet	☐	Jashtë ambienteve të shkollës
☐	Mensë	☐	Autobusin e shkollës
☐	Oborrin e shkollës	☐	Tjetër (specifiko) _____
☐	Familje	☐	

Njoftimi i personave/strukturave përgjegjëse:

	Po	Jo	Ora	Data
Njoftimi i prindërve/kujdestarëve ligjor	☐	☐	__:__:	____/____/20__
Njoftimi i policisë	☐	☐	__:__:	____/____/20__
Njoftimi i ambulancës/urgjencës	☐	☐	__:__:	____/____/20__
Njoftimi i zjarrfikëses	☐	☐	__:__:	____/____/20__

A rezultoi në një lëndim fizik ky incident/problematik?

☐ Jo

☐ Po, por nuk kërkonte kujdes mjekësor

☐ Po, dhe kërkoi kujdes mjekësor

Referimi i rastit:

	Po	Jo
Shërbimi psiko-social shkollor	☐	☐
Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës	☐	☐
Struktura të tjera	☐	☐

Hapat e ndërmarra:

Hartimi i planit të sigurisë/planit të masave nga oficeri i sigurisë

Plan ndërhyrje individual nga shërbimi psik-social shkollor

Hartimi i planit të ndërhyrjes në nivel klase

Hartimi i planit të ndërrhyrjes në nivel shkolle

Ngritja e grupit teknik ndërsektorial në nivel lokal

Trajtim në struktura të tjera të specializuara

Po Jo

Përshkrimi i incidentit/problematikës:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Informacione shitesë:

Ndihma e ofruar viktimës/të dëmtuarit:

Përmbledhje e gjetjeve dhe veprimeve të ndërmarra nga oficeri i sigurisë:

Raportuesi i incidentit/problematikës

_____ (emër mbiemër)	_____ (nënshkrimi)	____/____/20____ (data)
Oficeri i sigurisë		
_____ (emër mbiemër)	_____ (nënshkrimi)	____/____/20____ (data)

SINJALIZIMIT I HERSHËM I SJELLJEVE

PROBLEMATIKE

Një nga sinjalet më të hershme dhe të qarta për sjellje problematike është mungesa e rregullt në shkollë ose vonesat e përsëritura. Nxënësit që fillojnë të mungojnë shpesh, pa arsye të justifikuara, apo që vijnë rregullisht me vonesë, shpesh po përballen me vështirësi emocionale, mungesë motivimi ose probleme familjare. Pjesëmarrja reflekton angazhimin e tyre ndaj shkollës dhe kur ky angazhim bie, nevojitet një analizë më e thellë për të kuptuar shkaqet e fshehura.

Një rënie graduale apo e menjëhershme në notat e nxënësit, vështirësia në përmbushjen e detyrave, ose pamundësia për të përqendruar vëmendjen në mësim, janë tregues që shpesh lidhen me gjendjen emocionale, stresin, ose mungesën e përkrahjes në shtëpi. Performanca nuk duhet parë vetëm si rezultat i dijes, por edhe si pasqyrim i mirëqenies së përgjithshme të nxënësit. Kur nxënës të zakonshëm fillojnë të performojnë më dobët pa arsye të qarta, është koha të veprohet me vëmendje.

Shfaqja e sjelljeve të papërshtatshme, si ndërprerja e mësimin, mungesa e respektit për autoritetin, konfliktet me bashkëmoshatarët apo shpërthimet e zemërimit, janë shpesh një mënyrë për të treguar se diçka nuk po shkon mirë me nxënësin. Këto sjellje janë forma e jashtme e një brengje të brendshme dhe, nëse nuk adresohen me ndjeshmëri dhe strategji mbështetëse, mund të përkeqësohen dhe të dëmtojnë edhe të tjerët përreth.

Vëzhgimi i tërheqjes nga shokët, rritja e vetmisë, ndjenja e izolimit ose shenja të trishtimit të vazhdueshëm, mund të jenë sinjale të qarta të vështirësive psikologjike që një nxënës po përjeton. Marrëdhëniet me të tjerët – ose mungesa e tyre – janë tregues të rëndësishëm të shëndetit emocional. Kur një nxënës fillon të humbasë interesin për shoqërinë, përfshirjen në aktivitete ose tregon ankth të shpeshtë, është e nevojshme të aktivizohet mbështetja emocionale.

Mësuesit janë në pozicion unik për të identifikuar ndryshimet në sjellje apo qëndrime të nxënësve, pasi i shohin ata çdo ditë. Vërejtjet e përsëritura që mësuesit ndajnë në lidhje me një nxënës – si vështirësi në përqendrim, tërheqje, agresivitet apo shpërfillje e rregullave – janë sinjale që duhet të dokumentohen dhe analizohen me serioz. Kur shumë anëtarë të stafit shprehin shqetësim për të njëjtin nxënës, kjo përbën një sinjal të fuqishëm për ndërhyrje.

Shumë nga vështirësitë që përjetojnë nxënësit burojnë nga realitetet e tyre jashtë shkollës. Probleme si divorci i prindërve, humbja e një familjari, dhuna në shtëpi, varfëria, ose mungesa e përkujdesjes prindërore, ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe sjelljen e fëmijës në shkollë. Vlerësimi i kontekstit familjar është i domosdoshëm për të kuptuar jo vetëm *çfarë* po ndodh me nxënësin, por edhe *pse* po ndodh.

Vlerësimi i sinjalizimit të hershëm të sjelljeve problematike të nxënësve mund të përdoret në disa **momente kyçe gjatë vitit shkollor** dhe në **situata të veçanta**, për të siguruar që çdo nxënës që shfaq rrezik për përfshirje në sjellje problematike të mbështetet në kohë dhe në mënyrë efektive.

Vlerësimi i sinjalizimit të hershëm të sjelljeve problematike të nxënësve përdoret në momente kyçe kur shkolla synon të kuptojë më herët shenjat që tregojnë se një nxënës mund të jetë në vështirësi. Ky vlerësim mund të përdoret që në fillim të vitit shkollor, për të identifikuar nxënës që mund të kenë histori të mëparshme me vështirësi, që vijnë nga mjedise të reja ose që kanë kaluar ndryshime të rëndësishme në jetën familjare. Në këtë fazë, synimi është parandalimi dhe vendosja e një vëmendjeje të veçantë për ata që janë më të rrezikuar.

Gjithashtu, ky vlerësim është shumë i vlefshëm pas përfundimit të periudhave mësimore, kur analizohen mungesat, rezultatet akademike dhe sjelljet e përgjithshme të nxënësve. Është pikërisht në këto momente që mund të vërehen rënie të papritura në performancë, mungesa të shumta apo sjellje të pazakonta që kërkojnë analizë më të thellë.

Një tjetër rast kur vlerësimi bëhet i domosdoshëm është kur një nxënës ndryshon papritur sjellje – bëhet më i tërhequr, më agresiv apo më i shpërqendruar. Këto janë sinjale që mund të lidhen me probleme emocionale, vështirësi sociale ose ndonjë ngjarje të padukshme për stafin mësimor. Po ashtu, pas një incidenti disiplinor, si përfshirja në një konflikt apo thyerje e rregullave të shkollës, vlerësimi ndihmon për të kuptuar thellë shkaqet dhe për të ndërtuar një plan mbështetës e jo thjesht ndëshkues.

Në shumë shkolla, ky vlerësim përdoret edhe në mënyrë periodike – për shembull çdo muaj ose çdo tremujor – për të mbajtur një pasqyrë të qartë të mirëqenies dhe përfshirjes së të gjithë nxënësve, jo vetëm atyre me probleme të dukshme. Në këtë mënyrë, krijohet një kulturë proaktive dhe mbështetëse, ku ndërhyrjet nuk ndodhin vetëm kur problemet janë bërë të dukshme, por që më herët, për të parandaluar që ato të thellohen.



Në fund, ky vlerësim bëhet një mjet i fuqishëm edhe kur shkolla harton plane individuale duke monitoruar përparimin dhe përshtatur ndërhyrjet sipas situatës së tyre në kohë reale. Me pak fjalë, është një proces i gjallë, që ndihmon shkollën të jetë pranë nxënësit në mënyrë të kujdesshme, të zgjuar dhe me përgjegjësi.

FORMULARI I SINJALIZIMIT TË HERSHËM TË SJELLJEVE PROBLEMATIKE

DRAP:		ZVAP:	
Shkolla:		Lloji i shkollës:	☐ Publik ☐ Privat

Data e plotësimit:	____ / ____ / 20 ____
---------------------------	-----------------------

Zona e shkollës:	☐ Rurale	☐ Urbane
Lloji i shkollës:	☐ Arsim fillor	☐ Arsim Bazë
	☐ Arsim i Mesëm i Ulët	☐ Arsim i Mesëm i Lartë ⁴

Emri i nxnësit:	
Klasa:	

Shkalla e vlerësimit:

Asnjëherë = 1

Rrallë =

Mesatarisht = 3

Shpesh = 4

Gjithmonë = 5

Komponenti	Treguesi	1	2	3	4	5
Pjesëmarrja	1. Vonesat e përsëritura					
	2. Mungesat e pajustificuara					
	3. Largime të shpeshta nga ora e mësimi					
Performanca akademike	4. Ulje të menjëhershme ose graduale të notave					
	5. Detyra të paplota / të parealizuara					
	6. Vështirësi në teste					
Sjelljet dhe disiplina	7. Masa disiplinore					

⁴ Gjinnazet, shkollë e mesme e bashkuar, shkollat me drejtim të orientuar, shkollat profesionale.

	8. Vërejtje sistematike					
	9. Agresivitet i paprovokuar					
	10. Mospërfillje e rregullave të shkollës					
Treguesit emocionalë & socialë	11. Izolim social, mungesë miqsh					
	12. Luhatje humori, zemërim i shpejtë					
	13. Shprehje ankthi, depresioni,					
	14. Shpërthime emocionale të pazakonta					
Vështirësi në marrëdhënie me bashkëmoshatarët	15. Konfliktet të shpeshta me të tjerët					
	16. Të qenit vazhdimisht viktimë ose bullizues					
	17. Mungesë bashkëpunimi në punën në grup					
Raportimet e mësuesve / stafit	18. Prishje e mësim, ndërprerje të shpeshta					
	19. Mungesë respekti për autoritetin					
	20. Rekomandime/referime për takime me psikologun					
	21. Vlerësime të rrezikut nga shërbimi psiko-social					
	22. Vlerësime të rrezikut nga oficerët e sigurisë					
Ndikime negative nga mjedisi familjar ose shoqëror	23. Migrim, divorc, papunësi në familje					
	24. Mbikëqyrje e dobët prindërore					
	25. Historik i dhunës në familje					
	26. Varfëri ekstreme, mungesë përkujdesjeje					
	27. Shoqërim me individë me sjellje të rrezikshme (gang, përdorues substance)					

Niveli i riskut:

Risk shumë i lartë = 27- 40 pikë

Risk i ulët = 41-67 pikë

Risk mesatar = 68-95 pikë

Risk i lartë = 96-122 pikë

Risk shumë i lartë = 123-135 pikë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË PRINDIT NË

SMIP

Oficeri i sigurisë do të ketë një dritare të dedikuar në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) për komunikimet e tij me prindërit apo personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Hapësira e dedikuar do të shërbejë për të rritur komunikimin efektiv dhe në kohë reale midis oficerit të sigurisë dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Kjo hapësirë e dedikuar do të përdoret nga oficeri i sigurisë në dy momente kryesore:

1. **Kur nxënësi është shkaktuesi i një incidenti apo problematike** ndaj një nxënësi tjetër, mësuesi, stafi drejtues, objektit të shkollës, etj.
2. **Kur nxënësi është viktimë e një incidenti apo problematike** shkaktuar nga një nxënës tjetër, mësues, stafi drejtues, etj.

Plotësimi i kësaj fishe do të realizohet nga oficeri i sigurisë pas vlerësimit të rrezikut të incidentit apo problematikes dhe adresimit të zgjidhjeve të mundshme.

Plotësimi i kësaj fishe në hapësirën e dedikuar për komunikimet midis oficerit të sigurisë dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nuk përjashton mundësinë e nevojës së pranisë fizike të tyre në mjediset e shkollës.

RAPORTI JAVOR

Është formë raportimi për të përmbledhur gjithë punën javore të oficerit të sigurisë, aktivitetet e zhvilluara dhe problematikat e hasura, konkluzionet dhe përfundimet e punës së tij. **Ky raportim bëhet tek titullari i institucionit arsimor, personi i ngarkuar si anëtar i Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit në çdo ZVAP apo personi i ngarkuar nga ZVAP-ja për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla, dhe tek Specialisti i Policisë së Zonës.**

Dokumenti është i ndërtuar nga ballina e tij që përmban një informacion të detajuar të përgjithshëm dhe në dy pjesë kryesore të tij:

1. Pasqyra statistikore javore

Pasqyra statistikore javore përmbledh gjithë rezultatet e punës së oficerit të sigurisë për periudhën të cilën raporton. Këto të dhëna vijnë nga raportet e problematikave/incidenteve, të cilat, oficeri i sigurisë ka hartuar për secilin incident apo problematik.

2. Përmbledhje javore

Përmbledhja javore përshkruan aktivitetet e realizuara për periudhën e raportimit, përshkrimin e aktiviteteve, problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrës dhe përfundimet për personat të cilët ju dorëzohet ky format raporti.

INSTRUMENTI PËR RAPORTIMIN JAVOR

PËR OFICERËT E SIGURISË NË SHKOLLA

DRAP:		ZVAP:	
--------------	--	--------------	--

Shkolla:		Lloji i shkollës:	☐ Publik ☐ Privat
-----------------	--	--------------------------	--

Datat raportimit	___/___/20___	___/___/20___
